



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Hani i Elezit
Municipality Assambly of Hani Elezit

01/ Nr. 121 /2011

Bazuar në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale të Komunave të Republikës së Kosovës Nr. 03/L-040 nenin 12, neni 40, Ligjin për Transportin Rrugorë Nr. 2004/16 neni 6,7,19.2 dhe neni 41, Statutin e Komunës së Hanit të Elezit neni 6 pika (o), Rregulloren e punës së Kuvendit neni 15. Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur më datë: 23.11.2011 mori:

VENDIM

PËR

PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES PËR TRANSPORT RRUGORË NË TERRITORIN E KOMUNËS SË HANIT TË ELEZIT

I

Miratohet propozim vendimi me numër 01/Nr.121/2011 i datës 11.10.2011 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullore për Transport Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit e aprovuar nga Kuvendi i Komunës më datë 21.05.2009

II

Ndryshimet dhe plotësimet në rregulloren e përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi bëhen: në të gjitha nenet ku shënon Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave zëvendësohet Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencë, neni 4 pika 4.5 (a) të ketë së paku 2 (dy) autobusë zëvendësohet të ketë 1 (një) autobus, neni 4.5 (b) (01) mekanik për mirëmbajtje, respektivisht të ketë kontratë me servisën për mirëmbajtje, komisioni profesional zëvendësohet me komisionin komunal, në të gjitha vendet ku shënon rendin zëvendësohet me orarin, në të gjitha vendet ku shënon autobusë të zëvendësohet me autobusë apo kombibus, neni 6.1 si dhe orareve në to zëvendësohet si dhe orarin e udhëtimeve, te neni 6.1 të shtohen linjat Hani i Elezit – Gorancë-Glloboçicë, Hani i Elezit –Seçishtë – Krivenik, Hani i Elezit –Kashan –Laç, Ministria e Transportit dhe Post – Telekomunikacionit të shënohet vetëm Ministria përkatëse, neni 7.3 inspektorit të trafikut rrugorë të kuvendit komunal zëvendësohet me inspektorit përkatës të komunës, neni 18.2 drejtoria kompetente për komunikacion zëvendësohet me drejtoria e shërbimeve publike në kuadër të komunës, neni 20 drejtoria e urbanizmit dhe drejtoria e ekonomisë dhe financave zëvendësohet drejtoria përkatëse, neni 20 stacionet taksit zëvendësohen me vend qëndrimet për taksit, neni 21 pika (a) (05) pesë dyer zëvendësohet 4 (katër) dyer, neni 21 pika (c) taksimetri zëvendësohet me taksimetër, nenit 23 i shtohet edhe pika (f) të mos jetë në marrdhënie pune dhe të mos jetë pensionist, neni 24 pika (a) të sajë hiqet, neni 31 pika 31.1 Ministrisë zëvendësohet ministrisë përkatëse

III

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit nga Kuvendi i Komunës dhe është pjesë përbërëse e Rregullores për Transport Rrugorë në Territorin e Komunës së Hanit të Elezit të datës 21.05.2009.

IV

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit

V

Me këtë vendim njoftohen: Drejtoria e Shërbimeve Publike, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Shërbimi i Arkivit.

Hani i Elezit
Data: 30.11.2011

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Menduh Vlasi

